

Mrika LIMANI-MYRTAJ

Instituti i Historisë “Ali Hadri”

Email: limanimrika@gmail.com

ORCID:<https://orcid.org/0009-0000-2819-5557>

KUD: 305-055.2:94(496.51)(05)

**KOHA E JETUAR E GRAVE NË KOSOVË GJATË
DHE PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE: RISHKRIMI
I FEMINIZMAVE HISTORIKË NGA POSHTË****Abstrakt:**

Ky artikull propozon një historiografi feministe të Kosovës të ndërtuar mbi idenë e temporalitetit jolinear, kujtesës së trupëzuar dhe analizës strukturore të riprodhimit shoqëror. Në vend që historia e grave të paraqitet si një vijë progresi e pandërprerë gjatë socializmit, studimi e vendos kohën e jetuar të grave brenda ritmeve të mbivendosura të punës, ideologjisë dhe mbijetesës. Duke u mbështetur në konceptin e Victoria Browne për kohën feministe jolineare dhe në qasjet materialiste e afektive të Elizabeth Grosz, Silvia Federici dhe Verónica Gago, artikulli sfidon narrativat shtetërore që e paraqesin përfshirjen e grave si histori të mbyllur emancipimi. Këto pikënisje teorike mundësojnë një lexim të përvojave të grave jo si arritje të njëpasnjëshme, por si shtresa kohore ku përsëritja, shtyrja dhe dukshmëria e ndërprerë bashkëjetojnë. Përmes shqyrtimit të periodikëve dhe fushatave ideologjike gjatë Luftës së Dytë Botërore deri në periudhën e hershme socialiste, artikulli identifikon katër fusha tematike ku dalin në pah kontradiktat e emancipimit: heqja e mbulesës, amësia socialiste, pjesëmarrja në luftë dhe puna e përcaktuar brenda kufijve ideologjikë. Secila prej këtyre fushave tregon se si gratë shqiptare të Kosovës ishin herë të mbiekspozuara si shenja të transformimit ideologjik, herë të përjashtuara në mënyrë strukturore nga vendimmarrja. Për shembull, heqja e mbulesës u paraqit si liri, por shpesh u zbatua si kontroll i trupit të grave. Amësia u ngrit në nivel simbolik si themel i së ardhmes socialiste, ndërsa mbeti e rrënjosur në punë të papaguar që mbante gjallë jetën e përditshme. Pjesëmarrja e grave në rezistencë dhe luftë u glorifikua për të përforcuar narrativat shtetërore, edhe pse veprueshmëria e tyre konkrete u shtyp ose u fragmentua. Hyrja në tregun e punës u interpretua

si shenjë barazie, por u kushtëzua nga diskurset biologjike dhe amësore që kufizonin mobilitetin profesional. Këto raste zbulojnë një kohë të jetuar që mbetet e ngërthyer në struktura të përsëritura, pra, kurrë plotësisht e kapërcyer. Temporalitetet e kujdesit, riprodhimit dhe mbijetesës ndërthuren me pritjet për modernizim dhe përshpejtim socialist, duke krijuar një kohë të dyfishtë ku vazhdimësia patriarkale dhe kërkesat e ideologjisë socialiste ngarkojnë njëra-tjetrën. Artikulli kontribuon në kritikën ndaj historiografive socialiste dhe post-socialiste që e instrumentalizojnë përvojën e grave për qëllime ideologjike dhe mbështet argumentin për një metodë feministe që i reziston rrafshimit epistemik dhe që gjurmon format e pjesshme, të ndërprera dhe të brishta të kujtesës përmes së cilave mund të rindërtohen historitë nga poshtë. Në këtë mënyrë hapet mundësia për të rimarrë feminizma historikë që nuk u përfshinë kurrë plotësisht brenda kategorive që iu imponuan.

Fjalë kyçe: Historiografi feministë, gratë në Kosovë nën socializëm, ideologjia në Kosovë.

Abstract:

This article proposes a feminist historiography of Kosovo grounded in nonlinear temporality, embodied memory, and the structural analysis of social reproduction. Rather than presenting women's history as an uninterrupted line of progress under socialism, the study situates women's lived time within the overlapping rhythms of labor, ideology, and survival. Drawing on Victoria Browne's concept of nonlinear feminist time, alongside the materialist and affective approaches of Elizabeth Grosz, Silvia Federici, and Verónica Gago, the article challenges state narratives that depict women's incorporation as a completed story of emancipation. These theoretical starting points allow for a reading of women's experiences not as sequential achievements but as temporal layers in which repetition, deferral, and fragmented visibility coexist. Through close examination of periodicals and ideological campaigns from the Second World War to the early socialist period, the article identifies four thematic fields in which the contradictions of emancipation become evident: unveiling, socialist motherhood, wartime participation, and labor defined within ideological boundaries. Each of these fields shows how Albanian women in Kosovo were at times hyper-visible as signs of ideological transformation and at other times structurally excluded from decision-making. For example, unveiling was presented as liberation but was often enforced

as a form of bodily control. Motherhood was elevated symbolically as the foundation of the socialist future, while remaining rooted in unpaid labor that sustained everyday life. Women's participation in resistance and war was glorified to reinforce state narratives, even though their concrete agency was suppressed or fragmented. Entry into the labor market was interpreted as evidence of equality but was conditioned by biological and maternal discourses that restricted professional mobility. These cases reveal a lived temporality entangled in recurring structures, never fully surpassed. The temporalities of care, reproduction, and survival intersect with expectations of modernization and socialist acceleration, producing a double temporality in which patriarchal continuity and ideological demands mutually reinforce one another. The article contributes to critiques of socialist and post-socialist historiographies that instrumentalize women's experiences for ideological ends, and supports the case for a feminist method that resists epistemic flattening and traces the partial, interrupted, and fragile forms of memory through which histories from below can be reconstructed. In doing so, it opens space for recovering historical feminisms that were never fully encompassed by the categories imposed on them.

Keywords: Feminist historiography, women in Kosovo under socialism, ideology in Kosovo.

Hyrje

Roli i grave në historinë e Kosovës gjatë luftës dhe pasluftës së Dytë Botërore shpesh është reduktuar në përfaqësim simbolik ose është përfshirë nën narrativat patriarkale dhe nacionaliste, problematikë që është trajtuar më parë në një artikull tjetër.¹ Ndërkaq, ky artikull ndërhyn në këto historiografi dominuese duke nxjerrë në pah konceptin e *kohës së jetuar*, pra përvoja afektive, e trupëzuar dhe e strukturuar shoqërisht e temporalitetit. Qendrore për këtë analizë është teoria e Victoria Browne mbi kohën feministe jolineare, e cila refuzon narrativat progresive dhe me etapa të zhvillimit historik, duke theksuar në vend të tyre përsëritjen, njëkohësinë dhe ndërprerjen që karakterizojnë praninë historike të grave. Në këtë dritë, artikulli shqyrton

¹ Mrika Limani-Myrtaj dhe Fatmir Arifi, "Vëzhgime të përgjithshme mbi procesin emancipues të grave shqiptare në shekullin XX," *Kosova*, 2022, 109–31.

mënyrat se si gratë kosovare u mobilizuan përmes arsimit, propagandës dhe punës, por megjithatë mbetën të pozicionuara brenda kufijve patriarkalë të maskuar me retorikë ideologjike.

Në vend që të ndërtojë një strukturë të vetme teorike, ky artikull mbështetet në ndërthurjen e njohurive që e mbështesin dhe pasurojnë këtë kritikë të kohës. Teorizimi i Elizabeth Grosz mbi kohën e trupëzuar ofron një kuptim më të thellë për mënyrën se si trupat e grave regjistrojnë dhe përmbysin historinë. Silvia Federici dhe Verónica Gago ofrojnë një kritikë feministe materialiste mbi punën riprodhuese² dhe mënyrat se si kujdesi, afekti dhe qëndrueshmëria trupore instrumentalizohen si nën socializëm, ashtu edhe nën zhvillim neoliberal.

Silvia Federici ka argumentuar se puna riprodhuese si kujdesi, lindja, dhe qëndrueshmëria trupore, ka qenë historikisht e instrumentalizuar si bazë e akumulimit kapitalist dhe si element qendror i organizimit shoqëror, duke e shpjeguar këtë si në kuadër të tranzicioneve socialiste, ashtu edhe në fazat e neoliberalizmit. Në *Caliban and the Witch*, Silvia Federici e rikthen historinë e tranzicionit drejt neoliberalizmit nga perspektiva e trupit dhe punës së grave, duke argumentuar se nënshtrimi i tyre ishte po aq themelor për akumulimin fillestar sa eksproprijimi i tokës apo grabitja koloniale. Përmes një leximi feminist materialist, ajo e vendos gjuetinë e shtrigave në zemër të këtij procesi: jo si bestytini mesjetare, por si një projekt i dhunshëm politik dhe ekonomik, që kishte për synim shkatërrimin e autonomisë së grave dhe nënshtrimin e riprodhimit të tyre ndaj logjikës neoliberale. Trupi i gruas, kujdesi, riprodhimi dhe puna e padukshme u bënë tokë e re për akumulim,

² Puna riprodhuese i referohet të gjitha aktiviteteve materiale, afektive dhe shoqërore të nevojshme për prodhimin, mirëmbajtjen dhe riprodhimin e jetës njerëzore dhe të fuqisë punëtore. Kjo përfshin kujdesin (për fëmijët, të moshuarit, të sëmurët), punët shtëpiake, riprodhimin biologjik, si dhe punën emocionale dhe afektive që mundëson riprodhimin e marrëdhënieve shoqërore. Puna riprodhuese është historikisht e padukshme, e nënvlerësuar dhe kryesisht e papaguar, duke u vendosur në mënyrë disproporcionale mbi gratë. Ajo shërben si kusht strukturor për funksionimin e ekonomive kapitaliste dhe socialiste, sepse rindërton çdo ditë kapacitetin e punëtorëve për të punuar. Për më tepër shih Silvia Federici, *The Crisis of Social Reproduction: Silvia Federici and Mariarosa Dalla Costa in Conversation with Louise Toupin*, 1st ed, with Mariarosa Dalla Costa et al. (Between the Lines, 2025). Nancy Fraser, "Contradictions of Capital and Care," *New Left Review*, July 31, 2016, 99–117, <https://doi.org/10.64590/nt2>; Tithi Bhattacharya and Liselotte Vogel, eds., *Social Reproduction Theory: Remapping Class, Recentring Oppression*, Mapping Social Reproduction Theory (Pluto Press, 2017).

duke u instrumentalizuar në emër të një rendi të ri shoqëror,³ ndërsa në *Re-enchanting the World* thekson se puna riprodhuese dhe kujdesi mbeten fusha të shfrytëzimit dhe rezistencës edhe sot.⁴

Në mënyrë të ngjashme, Verónica Gago e koncepton ekonominë feministe jo si një teori abstrakte, por si një pedagogji popullore që lind nga praktikat e përditshme të grave dhe nga rrjetëzimi i tyre politik. Për Gagon, “ekonomia feministe” nuk është thjesht një degë e ekonomisë politike, por një mënyrë e re e të kuptuarit të jetës kolektive, e cila shfaqet në përballjen e drejtpërdrejtë me mekanizmat e borxhit, të dhunës financiare dhe të komodifikimit të kujdesit në neoliberalizëm.

Në këtë kuadër, greva rrethanore feministe nuk është një akt i izoluar apo një ngjarje e përkohshme, por një proces i vazhdueshëm që ndërthur jetën intime me atë politike. Duke bërë të dukshme varësinë e kapitalit nga puna e padukshme dhe e papaguar e grave si kujdesi, riprodhimi, mbarëvajtja e sferës afektive, greva (brenda kësaj kornize të diskutimit) krijon një horizont të ri politik që nuk kufizohet vetëm te vendi i punës, por shtrihet te shtëpia, komuniteti dhe marrëdhëniet shoqërore. Kjo e bën atë një mjet të fuqishëm për të kolektivizuar përvojat e fragmentuara dhe për t’i kthyer ato në një fuqi politike transformuese, ku vetë praktikat e përditshme të mbijetesës marrin kuptim emancipues.

Në këtë mënyrë, Gago e sheh ekonominë feministe si një laborator të përhershëm të rezistencës, ku riprodhimi nuk është më një fushë e heshtur shfrytëzimi, por një terren për ndërtimin e alternativave kolektive ndaj neoliberalizmit. Këtu, kujdesi dhe afekti nuk janë vetëm kategori teorike, por burime reale të fuqisë politike që, përmes grevës, marrin një funksion të qartë emancipues.⁵

Modeli strukturor i Kojin Karatani mbi mënyrat e shkëmbimit ofron një mjet të fuqishëm për të menduar jo vetëm mbi zhvillimin historik të formacioneve shoqërore, por edhe mbi mënyrën se si përvojat e grave janë formësuar nëpërmjet mbivendosjes së logjikave të ndryshme shoqërore. Karatani identifikon katër mënyra të shkëmbimit: A (reciprociteti i bazuar në farefisni), B (domininim dhe detyrim përmes shtetit), C (shkëmbimi i mallrave në treg) dhe D (një kombinim që shfaqet në kapitalizëm si sistem botëror). Në

³ Silvia Federici, *Caliban and the Witch: Women, the Body and Primitive Accumulation*, New York: Autonomedia, 2004, 61–118; 97–103; 163–190.

⁴ Silvia Federici, *Re-enchanting the World: Feminism and the Politics of the Commons*, Oakland, CA: PM Press, 2019, 71–94.

⁵ Veronica Gago, përkth. Liz Mason-Deese, *Feminist International*, 2020, 35–56; 121–143.

analizën e tij, këto mënyra nuk zëvendësojnë njëra-tjetrën në mënyrë lineare, por mbivendosen dhe ndërveprojnë, duke krijuar forma komplekse jetese dhe organizimi shoqëror.

Kur kjo kornizë përdoret për të kuptuar kohën dhe përvojën e jetuar të grave, bëhet e dukshme se ato kanë qenë të kapura njëkohësisht në rrjete të farefisit, në dhunën dhe mbikëqyrjen e shtetit, dhe në logjikën e tregut. Farefisnia u ka dhënë grave role riprodhuese dhe kujdestarie që shpesh kanë kufizuar lirinë e tyre, por gjithashtu kanë krijuar forma të rezistencës dhe mbijetesës kolektive. Pushteti shtetëror, veçanërisht në periudhat e socializmit, ka ofruar një retorikë emancipimi ndërkohë që ka ushtruar kontroll mbi trupat dhe punën e tyre, duke i instrumentalizuar ato për nevoja të kombit dhe ideologjisë. Tregtëzimi, nga ana tjetër, i ka futur gratë në një ekonomi të punës së paguar, por shpesh duke i mbajtur në pozita të pasigurta, duke forcuar dyfishimin mes punës riprodhuese të papaguar dhe punës produktive të nënvlerësuar.

Në këtë kuptim, përdorimi i modelit të Karatanit nuk shërben si bosht qendror analitik, por si një mjet orientues që ndihmon të kuptojmë se përvoja e grave nuk është formuar nga një logjikë e vetme, por nga ndërthurja e shumëfishtë e farefisnisë, shtetit dhe raporteve ekonomike mbisunduese. Kjo mbivendosje tregon pse përvojat e grave shpesh shfaqen si kontradiktore: ato janë njëkohësisht të mbështetura dhe të kufizuara nga farefisnia, të emancipuara dhe të kontrolluara nga shteti, të përfshira dhe të marginalizuara nga tregu.⁶ Këto rivendosje diskursive i konsideroj të domosdoshme për të shkëputur historinë bashkëkohore të gjinisë në Kosovë nga rrjedhshmëria zyrtare e historiografisë që i lë jetët e grave të pakanonizuara dhe në skaje të historisë.

Prandaj, tensionet e sipërshtuara e bëjnë të domosdoshme një histori “nga poshtë”, e cila i sheh gratë jo si figura simbolike, por si subjekte të kapura në nyjet e këtyre shkëmbimeve strukturore.

Korniza teorike: Historiografia feministe jolineare

Koncepti i Victoria Browne për kohën feministe jolineare sfidon modelin dominues të progresionit historik që ka formësuar si qasjet liberale, ashtu edhe ato socialiste mbi emancipimin e grave. Në vend që historia të shihet si

⁶ Kojin Karatani. *The Structure of World History: From Modes of Production to Modes of Exchange*, Durham: Duke University Press, 2014, 7–12.

një trajektore lineare nga shtypja në liri, Browne propozon që temporaliteti feminist të shfaqet në lakore, palosje dhe ndërprerje duke kapur trashëgimitë e dhunës, përjashtimit dhe rezistencës. Në rastin e Kosovës, kjo qasje është veçanërisht e dobishme për të interpretuar mënyrën se si trupat dhe kujtimet e grave u absorbuan në projektet ideologjike të formimit të shtetit, ndërkohë që nënshtrimi i tyre strukturor mbeti i paadresuar.

Elizabeth Grosz shton një dimension të rëndësishëm duke argumentuar se vetë trupi është një vend i përmbysjes kohore. Ajo dallon mes *Chronos* (koha sasiore, sequenciale) dhe *Kairos* (koha cilësore, afektive), duke theksuar se përvojat e grave si vajtimi, kujdesi ose qëndrueshmëria trupore, nuk mund të përkufizohen brenda kohës lineare historike. Këto kohëzgjatje të trupëzuara zbulojnë mënyrën se si ideologjitë politike shënohen në mish dhe afekt, dhe se si rezistenca mund të lindë përmes qëndrueshmërisë së këtyre shënimeve.

Sipas Grosz, *Chronos* është koha lineare dhe sasiore, ajo që matet, që rendit dhe përsëritet në mënyrë të rregullt dhe një kohë që na jep strukturë dhe vazhdimësi. Përballë saj qëndron *Kairos*, koha cilësore e ngjarjes, e rastësisë dhe e hapjes ndaj së paparashikueshmes. *Kairos* ndërhyt brenda vijimësisë së *Chronos*-it për ta orientuar ndryshe, për të hapur mundësinë e shndërrimit.

Këto dy mënyra nuk mbeten të ndara, por ndërthuren në trupin e njeriut. Trupi është një vend i shumëfishtë i kohës: nga njëra anë ai mbart vazhdimësinë, përsëritjen dhe qëndrueshmërinë e *Chronos*-it; nga ana tjetër, ai është i hapur ndaj transformimit, ndryshimit dhe rastësisë që sjell *Kairos*. Kështu, vetë përvoja e trupit e bën kohën jo thjesht lineare, por një fushë të ndërlikuar ku bashkëjetojnë rregulli dhe ndërprerja, qëndrueshmëria dhe hapja ndaj të resë.⁷

Kjo kornizë plotësohet nga perspektivat feministe materialiste që nxjerrin në pah rolin e punës riprodhuese dhe afektive në mirëmbajtjen e rendit shoqëror. Vepra e Silvia Federici mbi punën e papaguar shtëpiake dhe analiza e Verónica Gago mbi grevat feministe dhe rezistencën ekonomike nënvizojnë ndërthurjen e punës së gjinorizuar me sistemet e pushtetit. Në Kosovë, këto qasje ndihmojnë në teorizimin e mënyrës se si rolet e grave si nëna, kujdestare dhe figura simbolike kombëtare u instrumentalizuan në shërbim të projekteve shtetformuese, pa sfiduar normat patriarkale.

⁷ Elizabeth Grosz, *The Nick of Time: Politics, Evolution, and the Untimely*, Durham: Duke University Press, 2004, 5–7.

Ndërlidhjet historike: Gratë përtej roleve dhe regjimeve

Historia e grave në Kosovë gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore nuk mund të kuptohet si një vijë e drejtë e emancipimit, por si një terren i mbushur me kontradikta, përsëritje dhe transformime të pjesshme. Përtej retorikave shtetërore dhe narrativave ideologjike, trupat dhe përditshmëria e grave u bënë njëkohësisht shenjë e modernitetit socialist dhe vend i kufizimeve të vazhdueshme patriarkale. Ato u shfaqën në ceremoni publike, në fushata propagandistike dhe në mitologjinë e luftës, por zërat dhe agjencia e tyre shpesh mbetën të margjinalizuara.

Rastet që pasojnë ilustrojnë mënyra të ndryshme se si gratë shqiptare u vendosën në nyjet ndërmjet ideologjisë dhe jetës së përditshme: nga spektakli i heqjes së mbulesës⁸ si shenjë e civilizimit socialist, te figura e nënës si instrument i edukimit kombëtar; nga pjesëmarrja simbolike në luftë, te përfshirja e kushtëzuar në punën e paguar gjatë planeve zhvillimore. Secili prej këtyre rasteve tregon se kohët e grave nuk ishin të thjeshta si kronologji të emancipimit, por hapësira ku u mbivendosën tradita, pushteti shtetëror dhe tregu, një kohë jolineare që bart njëkohësisht shenja të dukshmërisë dhe të përjashtimit.

Burimet periodike të kësaj periudhe e kornizojnë emancipimin si ritëm institucional të matshëm: konferenca, buxhete, qendra bibliotekash, shkolla dyvjeçare për gra të rritura dhe kurse profesionale për prodhueset bujqësore. Megjithatë, raportimet në fshatra, si në Runik, tregojnë se vijueshmëria pengohej nga “mungesa e përpjekjes së faktorëve vendimtarë”, duke ekspozuar boshllëkun ndërmjet premtimit të modernizimit dhe kushteve të zbatimit. Në Drenas, gratë regjistroheshin për të ndjekur kurset për “metodat më moderne” të prodhimit, çka vërteton riformatimin socialist të rolit riprodhues në kapital teknik të planifikimit.⁹

Në vazhdë të këtij shtjellimi, edhe fushata e heqjes së mbulesës në Kosovën socialiste, ilustron mënyrën se si trupat e grave u bënë fushëbeteja ideologjike për modernitetin jugosllav. Kjo nuk ishte vetëm një politikë lokale, por pjesë e një diskursi më të gjerë civilizues që e shoqëronte mbulesën me

⁸ Për të njësuar argumentin që e parashtrij në këtë artikull, përgjatë artikullit e përdori termin mbulesë si tregues gjithëpërfshirës për veshjen fetare myslimane të grave, duke qenë shumë e vetëdijshme që ajo ekziston në forma të ndryshme të ndërvarura në mënyrë kulturore dhe tradicionale dhe se secila prej tyre e ka emrin e përveçëm që i gjegjet kohës dhe vendit.

⁹ “Nga mbledhja e Këshillit Ekzekutiv...,” *Rilindja*, 12 kallnuer 1956, 7; “Konferenca e XI e Këshillit të rrethit të sindikatave,” *Rilindja*, 12 kallnuer 1956, 7.

prapambetjen osmane dhe heqjen e saj me emancipimin socialist. Burimet periodike të kohës, si revista *Rilindja*, *Buletini* dhe *Agimi*, në artikujt e së cilave revista është bazuar kryesisht ky punim, dokumentojnë një gamë spektaklesh, nisur nga ceremonitë publike të heqjes së mbulesës te posterët didaktikë dhe narrativat mediatike që janë të ndërhuara për ta dramatizuar vizualisht transformimin e grave në subjekte moderne socialiste.

Megjithatë, kjo përfshirje vizuale dhe simbolike maskonte kontradikta më të thella. Gratë që hoqën mbulesën nuk fituan agjenci të plotë politike; ato u pozicionuan më shumë si shenja të modernizimit të suksesshëm të shtetit. Mbulesa, në këtë narrativë, u bë simbol i nënshtimit, dhe heqja e saj një spektakël i përputhjes ideologjike. Strategjia pedagogjike e shtetit ndërtoi gruan myslimane shqiptare si projekt civilizues dhe si simbol gjeopolitik, duke e raciaizuar atë në mënyrë të tërthortë si “tjetrën e brendshme”¹⁰ të Jugosllavisë:

...Kërkojmë ligjin për hjekjen e çarshafit dhe të peçes, pse e dijme se na shqiptaret i gëzojmë të drejtat e barabarta me të gjithë popujt tjerë të Jugosllavis; e kjo na shtyen që të kërkojmë që edhe grat dhe motrat t’ona të çlirohen njëherë e mirë nga errësina shekullore dhe ta gëzojnë lirin dhe barabaresin së bashku me të gjithë njerëzit e komunitetit t’onë”.¹¹

Nëpërmjet lentes së temporalitetit jolinear të Browne, heqja e mbulesës nuk shënon një shkëputje të vetme nga tradita në modernitet, por zbulon një strukturë të përsëritur të tejdukshmërisë simbolike dhe përjashtimit sistemik. Korniza e Grosz ndihmon të kuptojmë se ky transformim nuk ishte vetëm ideologjik, por edhe trupor, meqë trupat e grave u pozicionuan dhe u rrëfyer në dukshmëri, edhe pse zërat e tyre mbetën të munguar. Edhe semantika e përdorur në një artikull të revistës *Rilindja* nga viti 1954, raporti “*Emancipimi i grave asht detyrë shoqnore*”, e kornizon përfshirjen e grave si objektiv politik e kulturor të vetëqeverisjes socialiste. Shënohen “rezultate të dukshme” në përfshirjen e grave në jetën shoqërore e politike, në arsim e shëndetësi dhe në luftën kundër bestytnive, por njëkohësisht pranohet se “puna me grat ka karakter fushate” dhe shpesh “lehet në duer të disa shoqeve”, pra nënkupton mospërfshirje të gjerë.¹² Kjo vetëkritikë institucionale e tregon qartazi hendekun ndërmjet semantikës së progresit dhe kushteve reale të

¹⁰ Piro Rexhepi, *White Enclosures: Racial Capitalism and Coloniality along the Balkan Route*, On Decoloniality (Duke University Press, 2023).

¹¹ *Agimi*, Nëntor 1950, nr. 7, 13.

¹² “Emancipimi i grave asht detyrë shoqnore”, *Rilindja*, 17 kallnuer (janar) 1954, 1.

transformimit, duke përforcuar dallimin koselleckian mes hapësirës së përvojës dhe horizontit të pritjes. Nisma të tilla ishin në fakt pritja e etabluar e të gjitha sistemeve socialiste pas Luftës së Dytë Botërore. Siç e vëzhgon edhe Doan Dani në rastin e Shqipërisë socialiste dhe që përkon me vëzhgimet e Grosz për trupëzimin e gjinorizuar të agjencisë së grave:

Gjendja e gruas shqiptare përfaqësonte një prej lajtmotiveve kryesore të fushatës antifetare të viteve “60 të luftuar në emër të pritshmërisë eskatologjike komuniste, në emër të “ligjit të shenjtë të partisë”. Në një ese të vitit 1968, kushtuar gjendjes së prapambetur të gruas në fetë historike, Hako ndalej veçanërisht në format zakonore të Shqipërisë së Veriut, të përmbledhura në Kanunin e Maleve, i njohur edhe si Kanuni i Lekë Dukagjinit. Pa u larguar nga retorika e dispozitivëve të pushtetit, ai rimerrte disa aspekte të ligjërit propagandistik, të bëra publike prej kohësh nga Hoxha, që u masivizuan më pas në vitet “60. Në ndërhyrjen e tij të 13 tetorit të vitit 1955 në Kongresin IV të Bashkimit të Grave të Shqipërisë, Hoxha kishte deklaruar se” kanunet e sheriatit dhe të kishës të lidhura ngushtë me ligjet e borgjezisë, e bënë gruan, një plaçkë, send që blihej dhe shitej nga mashkulli, që shfrytëzohej pa mëshirë, që s’guxonte të hapte gojën për të thënë një mendim o një fjalë, por që kishte të drejtë vetëm të lindte fëmijë dhe të punonte ditë e natë si skllave.¹³

Në vazhdë me argumentin e Danit, dhe me lentën kritike të vështrimit historik, e shohim që edhe në Shqipëri, emancipimi u artikulua si mision i drejtpërdrejtë shtetëror, brenda një leksiku marksist-leninist që e refuzonte “feminizmin” perëndimor dhe e lidhi barazinë me përfshirjen në prodhim. Siç vëren Peter Prifti në një artikull të botuar në 1975, “Udhëheqësit e Partisë së Punës së Shqipërisë i denoncojnë lëvizjet e çlirimit të grave si “feministe,” “iluministe” dhe “gjoja apolitike”.”, duke e pozicionuar organin e Bashkimit të Grave të Shqipërisë si model për vendet e reja të pavarura: “Veprimtaria e Bashkimit të Grave të Shqipërisë është një shembull i shkëlqyer për shumë organizata të grave në vendet e sapo-pavarura.”¹⁴ Në planin normativ, Kushtetuta pohonte se “Gruaja është e barabartë me burrin në çdo sferë private, politike dhe të jetës sociale» por Prifti thekson kthjellët se “barazia de jure barazia nuk do të thotë barazi de fakto”.¹⁵ Përderisa ky punim paraqet

¹³ Doan Dani, *Sakralizimi i politikës në Shqipërinë komuniste (1944-1991)*, përkth. Edvin Cami, Tiranë: Pika pa sipërfaqe, 2024, 117–118.

¹⁴ Peter R. Prifti, “The Albanian Women’s Struggle for Emancipation,” *Southeastern Europe* 2, no. 1 (1975): 109, <https://doi.org/10.1163/187633375X00070>.

¹⁵ Peter R. Prifti, “The Albanian Women’s Struggle for Emancipation,” 116.

një shembull ilustrativ të perceptimit të asaj kohë, dhe padyshim është mbajtës i linjës zyrtare të ligjërimit, ai njëkohësisht ofron një skicë realiste të këtij procesi të ndërthurur me po atë politikë shtetërore që udhëheq procesin emancipator.

Të tilla arsyetime prapa këtyre nismave ishin prevalente edhe në vendet e tjera socialiste: në Bashkimin Sovjetik, procesi i heqjes së mbulesës nuk ishte thjesht një masë e emancipimit të grave, por një projekt i gjerë politik e ideologjik që lidhej me sekularizimin e shoqërisë dhe kontrollin e trupit femëror. Fushata e njohur si *Hujum*, e nisur në Uzbekistan më 1927, u paraqit nga autoritetet si “çlirim i grave” përmes heqjes së mbulesës, por në praktikë ajo solli dhunë, përjashtim dhe viktima. Siç dëshmon Marianne Kamp, shumë gra që hoqën mbulesën u përballën me sulme publike, izolim social dhe madje edhe vrasje, duke e bërë heqjen e mbulesës një proces traumatik dhe të imponuar nga lart, jo rezultat i emancipimit të brendshëm shoqëror.¹⁶

Ky imponim duhet lexuar në dritën e teorive mbi kolonializmin dhe modernizimin. Ashcroft, Griffiths dhe Tiffin argumentojnë se projektet e tilla për emancipim, të kryera nga shtete që ushtronin pushtet hegjemomik, ishin në fakt instrumente të kolonializmit të brendshëm, ku gratë bëheshin terren simbolik i betejës midis modernitetit dhe traditës.¹⁷ Në këtë kuptim, shfaqja e gruas së zbuluar në hapësirën publike ishte më shumë shenjë e fitores ideologjike të shtetit sesa zgjedhje e lirë.

Nëse i qasemi kësaj përvoje përmes lenteve feministe bashkëkohore, Silvia Federici do të theksonte se kontrolli mbi trupin e gruas nëpërmjet heqjes së mbulesës ishte pjesë e procesit të biopolitikës socialiste: gratë duhej të çliroheshin për të shërbyer si punëtore dhe prodhuese sociale në shërbim të modernizimit.¹⁸

Po kështu, Verónica Gago do të interpretonte rezistencën e grave që refuzuan të largonin mbulesën si një formë të “politikës së përditshmërisë”, që ishte në fakt një mënyrë për të thënë “jo” ndaj shtetit edhe brenda jetës së përditshme.¹⁹

¹⁶ Marianne Kamp, *The new woman in Uzbekistan*, Seattle: University of Washington Press, 2006, 87–90.

¹⁷ Bill Ashcroft, Gareth Griffiths, dhe Helen Tiffin, *The empire writes back*, London: Routledge, 2002, 103–105.

¹⁸ Silvia Federici, *Caliban and the witch*, Brooklyn, NY: Autonomedia, 2004, 33–36.

¹⁹ Verónica Gago, *Feminist International: How to Change Everything*, trans. Liz Mason-Deese (Verso, 2020), 41–44.

Nga ana tjetër, Ghodsee dhe Ballinger tregojnë se në Jugosllavi dhe Bullgari, heqja e mbulesës u krye jo përmes dhunës së menjëhershme, por në mënyrë më graduale, përmes përjashtimit institucional: mbulesa nuk lejohej në shkolla, administratë apo në vendin e punës. Këtu, sekularizmi socialist ishte një instrument i integritimit kulturor dhe uniformizimit shoqëror, ku gratë u shtynë drejt modernitetit socialist jo përmes terrorit, por përmes një presioni të vazhdueshëm shtetëror.²⁰

Megjithëse krahasimi përkitaz tregon se në Bashkimin Sovjetik heqja e mbulesës ishte një proces i dhunshëm, i imponuar dhe i mbushur me trauma kolektive, ndërsa në kontekste të tjera socialiste, si në Jugosllavi, ai ndodhi në formën e një përjashtimi të heshtur dhe gradual, çka vërehet është se në të dyja rastet, megjithatë, gratë nuk ishin aktore të plota të emancipimit, por objekte të projekteve shtetërore të modernizimit dhe sekularizimit.

Në Kosovën e periudhës socialiste, figura e nënës ishte po ashtu qendrore në aparatit ideologjik të shtetit. Publikime arkivore si *Buletini* i viteve 1947-1948 theksonin se kontributi më i rëndësishëm i grave në shoqëri ishte si edukatore të brezit të ri. Shprehje si “Çdo nënë ka një detyrë të shenjtë t’i dërgojë fëmijët e saj në shkollë”²¹ i riformatuan rolet tradicionale të nënës si instrumente të shtetndërtimit, e më tej si:

(...) Nana dërgoni fëmijët tuj në shkollë” - Nana e Sanijes. Luftat e përgjakshme nuk janë ba për robnimin e njerëzve, pushteti populluer nuk na mëson që neve fëmijë ta mbajmë në shtëpi por përkundrazi me e dërgue në shkollë. Ajo përpiket që të zhduki sa ma shpejt analfabetizmin, e jo me ba analfabet të ri.

Atdheu ynë i cili shkon kah ndërtimi i socializmit don njerëz t’armatosun me dituni e jo njerëz injoranta.

Prandaj, të gjithë ju nana dërgoni fëmijët t’uej në shkolla, edukoni fëmijë t’uj në frymën socialiste ashtu si ka thanë shum herë shoku Tito.²²

Vida Tomšić, përfaqësuese e Frontit Antifashist të Grave, duke interpretuar direktivat nga Kongresi i 5-të i Partisë Komuniste, shkante edhe më tej, duke deklaruar se gratë duhet të bëhen “edukatorët më të mirë të brezit të ri,” jo vetëm për familjen, por për kombin socialist. Kjo retorikë funksiononte brenda një kornize më të gjerë ku puna shtëpiake e grave u rishpërblye si

²⁰ Pamela Ballinger dhe Kristen Ghodsee, “Socialist Secularism,” *Aspasia* (January 2011), 5: 1, 58–61.

²¹ *Buletini*, nr. 2, 1947.

²² *Buletini*, nr. 16, 1948, 6.

detyrë publike. Megjithatë, ky rishpërblim nuk e çrrënjosi ndarjen gjinore të punës, por përkundrazi, e përforcoi atë përmes ngritjes ideologjike. Puna afektive dhe morale e nënave u përvetësua nga pedagogjitë shtetërore pa u shoqëruar me rritje të autonomisë ose qasje reale në pushtet.

Nga perspektiva e kohës feministe jolineare, kjo strategji shtetërore nuk inauguronte një epokë të re emancipimi, por risistemonte rolet e vjetra në terma socialistë. Koncepti i Grosz për kohën e trupëzuar tregon se si gratë u vendosën për të përthithur punën emocionale dhe kohore të të ardhmes socialiste: kujdesin për fëmijët, transmetimin e ideologjisë dhe mirëmbajtjen e jetës së përditshme. Kritika e Federicit mbi riprodhimin shoqëror shpjegon se si kjo punë e papaguar, megjithëse e ngritur retorikisht, mbeti strukturarisht e padukshme.

Historiografia socialiste e pasluftës në Jugosllavi i ngriti në mënyrë retroaktive edhe kontributet e grave shqiptare në luftë për të ndërtuar një narrativë kombëtare të barazisë gjinore dhe heroizmit revolucionar. Megjithëse pjesëmarrja e tyre numerikisht ishte marginale krahasuar me rajone të tjera, gratë shqiptare u mobilizuan simbolikisht për të mishëruar idealin e gruas komuniste: e disiplinuar, militante, por e rrënjosur në amësi.

Siç theksojnë studiueset si Kojqini-Ukaj²³ dhe Bakija-Gunga²⁴, kontributet e grave ishin kryesisht të kufizuara në fusha të përcaktuara në mënyrë të gjinorizuar si qepje, përgatitje ushqimi, komunikim i fshehtë dhe kujdes. Këto forma pjesëmarrjeje, megjithëse kritike, nuk u konsideruan agjenci e plotë politike, por zgjatime të detyrës shtëpiake të orientuara drejt kauzës partizane. Pas luftës, këto veprime u rirrefyën si akte subjektiviteti revolucionar.

Shteti ndërtoi një mitologji rreth “nënës partizane” si një figurë që bashkonte kujdesin riprodhues me mbrojtjen kombëtare. Kjo barrë e dyfishtë u portretizua si heroike, duke maskuar vazhdimësinë e normave patriarkale si në ideologji, ashtu edhe në jetën institucionale. Shpallja e 88 “Heroinave të Popullit” në gjithë Jugosllavinë, përfshirë 4 nga Kosova²⁵, shërbeu për të legjitimuar narrativen e barazisë gjinore, ndërsa fshihte nënshtrimin strukturor.

²³ Sulltane Kojqini-Ukaj, “Zhvillimi dhe masivizimi i frontit antifashist të grave të Kosovës 1943-1945.” *Kosova* 6, 1977.

²⁴ Drita Bakija-Gunga, *Gratë e Kosovës në periudhën e ndërtimit socialist (1945-1978)*. Prishtinë: Instituti i Historisë së Kosovës, 1986.

²⁵ Sulltane Kojqini-Ukaj. 1977. “Zhvillimi dhe masivizimi i frontit antifashist të grave të Kosovës 1943-1945.” *Kosova* 6, 1977, 111.

Korniza e Browne e sqaron këtë strategji simbolike: nuk ishte një shkëputje historike, por një mbivendosje kohore, ku hierarkitë gjinore tradicionale u ripërdorën në vend që të çrrënjosen. Trupat e këtyre grave bartin gjurmë të punës, sakrificës dhe shënimit shtetëror që janë gjurmë materiale e diskursive që i rezistojnë kategorizimeve të thjeshta historike. Përtej kësaj, pas Luftës së Dytë Botërore, Jugosllavia socialiste nisi programe ambicioze të zhvillimit ekonomik, veçanërisht planet pesëvjeçare, të cilat inkurajuan pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore si shenjë e modernizimit socialist. Për shumë gra shqiptare në Kosovë, kjo shënoi hyrjen e parë në punë të paguar ose në role ekonomike të njohura nga shteti. Megjithatë, materialet arkivore si *Buletini* zbulojnë kontradiktat ideologjike të kësaj përfshirjeje.

Një artikull i vitit 1947 raportonte:

Sot, në këtë kohë të përpjekjes drejt Planit Pesëvjeçar, duhet të përpiqemi t'i shfrytëzojmë të gjitha forcat tona. Shumë prej nesh, gra, po marrim pjesë për herë të parë në ekonomi. Ka shumë vende pune ku ne, për shkak të përbërjes sonë fizike dhe si nëna, nuk mund të marrim pjesë.²⁶

Ky formulim ambivalent tregon se premtimi i emancipimit kufizohej nga biologjizimi i kapaciteteve të grave dhe roli qendror i amësisë. Ndërkaq, diskursi shtetëror e portretizonte këtë pjesëmarrje si vullnetare dhe progresive, por korniza e punës së grave ishte gjithmonë kushtëzuese: ato mund të punonin, por vetëm aty ku rolet e tyre trupore dhe amësore e lejonin. Ky përjashtim strategjik përforconte ndarjet gjinore në vend që t'i çrrënjoste ato. Ai gjithashtu arsyetonte nënvlerësimin e punës së grave dhe kufizimin e qasjes së tyre në role më të kualifikuara ose vendimmarrëse. Siç e vë në pah edhe studiuësja Keçmezi-Basha, regjimet pasluftës përdorën figurën e gruas heroinë për të ndërtuar narrativën e emancipimit socialist, duke lënë anash realitetin e tyre të përditshëm.²⁷

Kritika e Federicit mbi riprodhimin shoqëror kapitalist e socialist e mprehtëson këtë lexim: apeli i shtetit ndaj identitetit amësor shërbente për të nxjerrë punë, duke ruajtur njëkohësisht hierarkitë patriarkale. Vëzhgimi i Gagos mbi rraskapitjen e punës së feminizuar është i ngjashëm këtui, ku pjesëmarrja u formulua si fuqizim, por gratë mbartnin barrën e dyfishtë të produktivitetit brenda dhe jashtë shtëpisë, pa njohje strukturore.

²⁶ *Buletini*, nr. 5–6, 1947, fq. 10.

²⁷ Sabile Keçmezi - Basha, "Gratë Shqiptare Për Çështjen Kombëtare," *Kosova*, nos. 35–36 (2012): 7–8.

Përfundime

Ky artikull ka propozuar një historiografi feministe të Kosovës të bazuar në temporalitet jolinear, kujtesë të trupëzuar dhe analizë strukturore të riprodhimit shoqëror. Përmes lentes së kohës feministe jolineare të Victoria Browne, të plotësuar me qasjet e Elizabeth Grosz, Silvia Federici dhe Verónica Gago, ai ka sfiduar narrativat shtetërore, lineare dhe progresive mbi emancipimin e grave nën socializëm. Në vend se përfshirja e grave të interpretohej si një arritje historike me trajektore të qartë, artikulli tregon se kjo përfshirje shpesh funksiononte në mënyrë simbolike, duke maskuar regjime më të thella të kufizimit gjinor dhe përvetësimit ideologjik. Katër temat bosht si heqja e mbulesës, amësia socialiste, pjesëmarrja në luftë dhe puna nën kufizime, zbulojnë se si gratë shqiptare të Kosovës ishin herë të mbiexpozuar, herë të përjashtuara strukturalisht. Heqja e mbulesës u formulua si liri, por u zbatua si survejim; amësia u ngrit retorikisht, ndërsa mbeti një vend pune i papaguar; pjesëmarrja në rezistencë u glorifikua për të legjitimuar narrativat shtetërore, ndërsa agjencia reale u marginalizua; dhe hyrja në fuqinë punëtore u kushtëzua nga diskurset biologjike dhe amësore. Secili rast dëshmon se koha e jetuar e grave ishte e ngërthyer në struktura përsëritëse, pra kurrë plotësisht e kaluar dhe kurrë plotësisht e zgjidhur. Duke nxjerrë në pah punën e trupëzuar dhe afektive, ky artikull kontribuon në një kritikë më të gjerë të historiografive socialiste dhe post-socialiste që i instrumentalizojnë përvojat e grave për qëllime ideologjike. Ai argumenton për një metodë feministe që i reziston rrafshimit epistemik dhe si e tillë tenton ta njohë një metodë që kupton përsëritjen e nënshtrimit, diskontinuitetin e dukshmërisë dhe rëndësinë e kujtesës së pjesshme, të shoshitur, në shkrimin e historisë nga poshtë. Duke bërë këtë, hapet hapësira për të rimarrë feminizma historikë që kurrë nuk u përfshinë plotësisht nga kategoritë që iu dhanë.

Bibliografi:

Monografi & Punime shkencore:

- Bill Ashcroft, Gareth Griffiths, and Helen Tiffin. *The Empire Writes Back: Theory and Practice in Post-Colonial Literatures*. 2. ed. New Accents. Routledge, 2002.
- Doan Dani. *Sakralizimi i Politikës Në Shqipërinë Komuniste (1944-1991)*. Translated by Edvin Cami. Pika pa sipërfaqe, 2024.
- Federici, Silvia. *Caliban and the Witch*. Second, Revised edition. Autonomedia, 2004.
- Gago, Verónica. *Feminist International: How to Change Everything*. Translated by Liz Mason-Deese. Verso, 2020.
- Marianne Kamp. *The New Woman in Uzbekistan: Islam, Modernity, and Unveiling under Communism*. Jackson School Publications in International Studies. University of Washington Press, 2006.
- Mrika Limani Myrtaj dhe Fatmir Arifi. “Vëzhgime Të Përgjithshme Mbi Procesin Emancipues Të Grave Shqiptare Në Shekullin XX.” *Kosova*, 2022, 109–31.
- Nancy Fraser. “Contradictions of Capital and Care.” *New Left Review*, July 31, 2016, 99–117. <https://doi.org/10.64590/nt2>.
- Pamela Ballinger and Kristen Ghodsee. “Socialist Secularism: Religion, Modernity, and Muslim Women’s Emancipation in Bulgaria and Yugoslavia, 1945-1991.” *Aspasia* 5, no. 1 (2011). <https://doi.org/10.3167/asp.2011.050103>.
- Peter R. Prifti. “The Albanian Women’s Struggle for Emancipation.” *Southeastern Europe* 2, no. 1 (1975): 109–29. <https://doi.org/10.1163/187633375X00070>.
- Piro Rexhepi. *White Enclosures: Racial Capitalism and Coloniality along the Balkan Route. On Decoloniality*. Duke University Press, 2023.
- Silvia Federici. *The Crisis of Social Reproduction: Silvia Federici and Mariarosa Dalla Costa in Conversation with Louise Toupin*. 1st ed. With Mariarosa Dalla Costa, Louise Toupin, and Käthe Roth. *Between the Lines*, 2025.
- Tithi Bhattacharya and Liselotte Vogel, eds. *Social Reproduction Theory: Remapping Class, Recentring Oppression*. *Mapping Social Reproduction Theory*. Pluto Press, 2017.

Revista:

- *Agimi*, Nëntor 1950, nr. 7.
- *Buletini*, nr. 2, 1947; nr. 16, 1948; nr. 5–6, 1947.
- *Rilindja*, 12 kallnuer (janar) 1956; 17 kallnuer (janar) 1954.

Mrika LIMANI-MYRTAJ

The Institute of History "Ali Hadri"

Email: limanimrika@gmail.com

ORCID: <https://orcid.org/0009-0000-2819-5557>

KUD: 305-055.2:94(496.51)(05)

SUMMARY**THE LIVED EXPERIENCE OF WOMEN IN KOSOVO AFTER
THE SECOND WORLD WAR: REVISITING HISTORICAL
FEMINISMS FROM BELOW**

This article has proposed a feminist historiography of Kosovo grounded in nonlinear temporality, embodied memory, and a structural analysis of social reproduction. Through the lens of Victoria Browne's feminist nonlinear time, supplemented by the approaches of Elizabeth Grosz, Silvia Federici, and Verónica Gago, it has challenged state-centered, linear, and progressive narratives of women's emancipation under socialism. Rather than interpreting women's inclusion as a historical achievement with a clear trajectory, the article shows that such inclusion often functioned symbolically, masking deeper regimes of gendered restriction and ideological appropriation. Four central themes - the unveiling campaign, socialist motherhood, participation in the war, and labor under constraint- reveal how Albanian women in Kosovo were at times hyper-visible and at other times structurally excluded. Removing the veil was framed as liberation but implemented as surveillance; motherhood was elevated rhetorically while remaining an unpaid site of labor; participation in the resistance was glorified to legitimize state narratives while women's actual agency was marginalized; and entry into the workforce was conditioned by biological and maternalist discourses. Each case demonstrates that women's lived time was entangled in repetitive structures, never fully past and never fully resolved. By foregrounding embodied and affective labor, this article contributes to a broader critique of socialist and post-socialist historiographies that instrumentalize women's experiences for ideological purposes. It argues for a feminist method that resists epistemic flattening and instead seeks to recognize a mode of analysis attentive to the recurrence of subordination, the discontinuity of visibility, and the importance of partial,

filtered memory in writing history from below. In doing so, it opens space to reclaim historical feminisms that were never fully encompassed by the categories imposed upon them.